

## **PERMBLEDHJE JO TEKNIKE TE RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS.**

Subjekti "TERNOVA CHROME RESOURCES" sh.p.k. me administrator z. Perparim Kuçi i regjistruar si person Juridik prane Q.K.R-se me date 29.05.2012 dhe me numer NIPT-i L21729004G ka hartuar Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per zgjerimin e kordinatave te lejes minerare nr.1611 date 25.01.2013 me Urdher te Ministrit nr.5648/1 prot date 06.07.2018 , objektin " Kaptina – Livadhi i Dashit" ne zonen e Ternoves Rrethi Bulqize ne kuoten nen 1670 m mbi nivelin e detit . Ky raport eshte pergatitur ne zbatim te ligjit Nr.10440 dt.07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " dhe Vendimit te keshillit te Ministrave Nr.419 dt. 25.06.2014 " Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipeve A,B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt ne tjetrin, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL- ja ".

### **1.1 Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit , detaje te aksesit dhe transportit, si dhe numri i njerezve qe do te punesohen dhe nga do te vijne ata.**

Ky studim ka per qellim qe te planifikoje dhe drejtoje konform rregullave e kushteve tekniko ekonomike , shfrytezimin e rezervave gjeologjike te mineralit te kromit ne objektin " Kaptina – Livadhi i Dashit " Ternove, Rrethi Bulqize . Shfrytezimi i mineralit te kromit do te behet sipërfaqe me karriere dhe ne nentoke me ane te punimeve te shpim plasjes ne miniere .Projekti ne fjale ka nje sipërfaqe prej 0.791 km<sup>2</sup> e cila ndodhet ne zonen Ternoves. Si rezultat i shfrytezimit te rezervave gjeologjike te mineralit te kromit jane parashikuar te nxiren rreth 18 835 ton krom me cilesi 22.95 %Cr<sub>2</sub>O.

Persa i perket rrjetit te transportit , ky rrjet eshte i ndertuar dhe eshte mirembajtur vazhdimisht .

Per shfrytezimin e ketij objekti subjekti ka parashikuar te punesoje rreth 17 punonjes perfshire dhe stafin teknik.

## **1.2. Kerkesat e perdorimit te tokes dhe karakteristike te tjera fizike te projektit**

Projekti do te zbatohet ne objektin “ Kaptina – Livadhi i Dashit” Ternove. Ne kete objekt do te behet vetem shfrytezimi i mineralit te kromit . Sheshi i depozitimit te sterilit dhe te mineralit do te jete jashte fushes minerare ne siperfaqe.

Nga aktiviteti i shfrytezimit te mineralit ne kete objekt kemi te bejme me perdorim te tokes per siperfaqen qe do te shfrytezohet me karriere dhe nuk kemi te bejme me perdorim te tokes per shfrytezimin me nenoke, si persa i perket periudhes se hapjes , shfrytezimit apo mbas tyre .

## **1.3 Proçesi i prodhimit dhe karakteristikat e tij .**

Aktiviteti te cilin do te ushtroje subjekti eshte bazuar ne Ligjin Minerar Shqiptar dhe konsiston ne shfrytezimin e mineralit te kromit . Per te shfrytezuar keto rezerva , nga subjekti do te hapen punime te cilat do te kalojne neper trupin minerar . Produkt i ketyre punimeve eshte minerali i kromit dhe si i tille do te depozitohet ne sheshin e depozitimit te mineralit dhe do te transportohet me mjetet e transportit per ne destinacion sipas kerkesave te tregut .

## **2 Pershkrimi i vendit dhe mjedisit te tij .**

Vendi ku kerkohet te ushtrohet aktiviteti i nxjerrjes se mineralit te kromit , pra objekti “ Kapina – Livadhi i Dashit “, eshte nje zone brenda fushes minerare te lejes minerare nr.1611 date 25.01.2013, larg fshatit te Ternoves . Keshtu qe fuqia punetore do te merret kryesisht nga Ternova dhe nga fshatrat perreth . Klima e zones eshte kontinentale , me vere te nxehte e te thate e dimer te ftohte. Objekti eshte i lidhur me rrugen nacionale Bulqize – Tirane , e cila aktualisht eshte e punueshme , ne te kalojne mjetet qe transportojne punetoret e mineralin e kromit . Aktiviteti do te zhvillohet ne brendesi te minieres dhe per rrjedhoje ky aktivitet nuk do te ndikojte absolutisht ne floren dhe faunen e siperfaqes edhe pse keto nuk jane

te mbrojtura me status te veçante apo te bejne pjese ne lloje dhe specie te varieteteve te veçanta .

Ujrat nentokesore, qe permbajne trupat xeherore dhe shkembinjte rrethues , jane te çarjeve dhe si rrjedhim kane nje shperndarje jo te njetrajtshe . Prurjet e ujit qe ushqehen nga ujrat siperfaqesore jane ne varesi te thellesise se punimeve dhe jane me te medha ne kohe me rreshje dhe gjate shkrirejtes se deboret . Por eshte e sigurte qe ujrat nentokesore te cilat shtohen gjate rreshjeve dhe shkrirejtes se deboret do te dalin ne siperfaqe nga punimet e kryera me poshte , dhe ne keto galeri nuk pritet te kete ujra dhe probleme gjate shfrytezimit te mineralit te kromit .

Kjo zone nuk perben rendesi te trashegimise arkitektonike sepse ne kete zone nuk ka asnje lloj ndertimi te kohes se sotme apo te kohes se kaluar . Rendesia e kesaj zone , si e gjithe masivit te Bulqize - Batres, qendron ne potencioalin e madh qe ka nentoka , persa i takon mineralit te kromit .

Nga pikpamja e rilievit , vendi ku eshte hapur miniera i perket nje zone malore e ç'veshur nga bimesia e larte .

Gjate shfrytezimit te objektit parashikohet rigjenerimi hap pas hapi i zones se shfrytezimit , me kryerjen e punimeve suplementare te mbushjes dhe sistemimit .

Kjo zone nuk ben pjese ne zonat e caktuara me ligj si rezervate kombetare , zone me interes shkencor te veçante , park kombetar , zone me bukuri te rralla natyrore, brigjet e trasheguara , parqet rajonale dhe rurale, parqet pyjore kombetare, rezervat lokale natyrore , zonat ujore te mbrojtura , monumentet e lashtesise , si dhe zonat me rendesi arkeologjike .

Ne zonen ku do te ushtrohet aktiviteti i shfrytezimit te mineralit te kromit , nuk ka zogj te eger te cilet duhet te mbrohen sipas direktivave te BE per “ Zogjte e Eger “. Gjithashtu zona eshte larg qendrave te banuara dhe nuk perfaqeson ndonje zone , e cila te trajtohet konform Konventes Boterore Kulturore apo Konventes se Ramsarit .

### 3. Vleresimi i ndikimeve .

Zbatimi i projektit nuk do te ndikojë ne popullsi per vete faktin se ai do te zbatohet larg qendrave te banuara . Si ndikim permendim punesimin e nje numri punonjesish dhe hapjen e perspektives per ritjen e numrit te punonjesve te punesuar .

Nga zbatimi i projektit nuk do te kete ndryshim te pejsazhit .

Per sa i perket niveleve te ndikimeve e emetimeve te ardhura nga projekti verezime se ato jane zero , sepse ky projekt konsiston ne marrjen e mineralit ne nje miniere te re. Operacionet do te kryhen ne nentoke te cilat nuk emetojne elemente te demshem per mjedisin .

Persa i perket nivelit te zhurmave gjate operacioneve te punes ,siç eshte shpimi i birave, kemi te bejme me nivele qe i kalojne normat e lejuara. Ne menyra qe te eliminohet ndikimi i tyre , punonjesit do te paisen me kufje per tu mbrojtur nga zhurmat .

Projekti i shfrytezimit do te zbatohet ne nentoke , ne nje zone ku as ne siperfaqe te saj dhe as ne nentoke nuk ka ndertime te trashegimise arkitektonike dhe historike , tiparet arkeologjike , si dhe vepra te tjera njerezore .

Zona e objektit, ne pergjithesi eshte e xhveshur nga bimesia me perjashtim te barishteve dhe shkurreve te ulta . Ne siperfaqe nuk ka pyje dhe drure te larte . Po ashtu dhe fauna karakteristike e zones eshte e paprekshme nga efektet e shfrytezimit .

Gjate dhe pas shfrytezimit nuk do te kete ndryshime ne topografine locale. Ne kete projekt eshte parashikuar nje rradhe dhe drejtim i tille shfrytezimi , qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes , sistemimit dhe trajtimit , parandalojne erozionin , shembjen dhe vithisjen e siperfaqes se tokres perreth saj .

Aktiviteti parashikon vetem shfrytezimin e mineralit te kromit dhe nuk leshon elemente kimike ose te tjere te demshem per mjedisin .

Siperfaqja qe do ti nenshtrohet shfrytezimit nuk eshte toke bujqesore . Ushtrimi i aktivitetit nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore .

Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit eshte parashikuar sistemimi, perpunimi, shtrimi dhe ndertimi i nje sere murrresh mbajtese ne stogjet e sterileve te trasheguara .

Gjate ushtrimit te aktivitetit, subjekti do te kryeje çdo vit sistemime dhe rregullime perr rreth objektit .

Siperfaqja qe do ti nenshtrohet shfrytezimit, pas perpunimit, trajtimit, sistemimit dhe mbulimit te pjesshem te saj , do te kthehet ne nje siperfaqe te mbjelle kryesisht me pisha , barishte e shkure dhe peme karakteristike te zones .

#### 4. Masat zbutese

Per shmangien dhe parandalimin e erozionit, shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme, ne projekt eshte parashikuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapshire i zones ne teresi . Gjithashtu subjekti çdo vit do te kryeje punime te ndryshme sistemimi te sterileve te depozituara ne stogjet ekzistuese .

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem, te parashikuar ne projekt do te varen nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit do te çoje perfundimisht ne perfitimin e pamjeve te parashikuara ne projekt me siperfaqe te sistemuara dhe te gjelberuara .

Pergatiti permbledhjen **Ing . Remzi PUPLI**

Liçencuar nga Ministria e Mjedisit Nr.427 dt . 01.08.2007





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 224 572 Fax. 0 4 270 627 [www.moe.gov.al](http://www.moe.gov.al)

Nr. 422 Prot.

Tiranë, më 01.08.2007

Vendimi nr. 9, Nr. 244 Regj.

**ÇERTIFIKATË**


Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

**"Remzi PUPLI"**

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

**MINISTRI**

*L. Xhuvelli*  
**Lufter XHUVELI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Ministria e Ekonomisë,  
Tregutit dhe Energjetikës



## LICENCË

**OK!**

DENDRA KOMBËTARE E LICENCIMIT  
NATIONAL LICENSING CENTER

LN-7383-01-2014	NUJS/NIPT: L17126401H
Subjekti: "REAL-P"	
Adresa: Diber, BULQIZE, Bulqize, Lagjja Minatori.	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 29/01/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat

### Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

### Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

### Veprimtari specifike

- Ndikim në mjedis
- Auditim mjedisor

### Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis. Auditim mjedisor.

### Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi


### Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

### Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i sportellit:



*Handwritten signature and date: 29/01/2014*